



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 38 prot.

Kamëz, më 21.03. 2024

V E N D I M

Nr 32 Datë 21/03/2024

PËR

**“NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 17 DATË 22.02.2024 MBI “MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2024”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.03.2024, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.28 Datë 18.03.2024 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar, ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative”; Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 “Rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim”; Udhëzim nr.31 dt.18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti shtetit për programet e strehimit”; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.112 datë 18.12.2023 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”; Vendimit nr.141 datë 25.11.2022 të Këshillit Bashkiak “Për një ndryim të Vendimit nr. 96 datë 20.11.2023 për Sistemin e Pikëzimit” VKB nr 103 dt.18.12.2023 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2024, 2025, 2026”; Vendimin nr.17 datë 22.02.2024 për “Miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato familje në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2024”; Shkresës me nr. Prot. 572 dt. 23.01.2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Relacionit të Komisionit të Strehimit me nr.894 Prot datë 31.01.2024; Procesverbalit Komisionit Strehimit me nr. Prot nr.894/1 Prot datë 31.01.2024, **Këshilli Bashkiak Kamëz;**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të tabelës nr.4 të Vendimit nr. 17 datë 22.02.2024 dhe trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë një vjeçare duke filluar nga data 01.01.2024 deri në datën 31.12.2024.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 *do të përballohen me bashkëfinancim në raportin 50% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe 50% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.*
4. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

